



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM

Nr. 31, datë 23.01.2020

MBI

**NUMRIN E KANDIDATËVE QË DO TË PRANOHEN NË PROGRAMIN E FORMIMIT
FILLESTAR PRANË SHKOLLËS SË MAGJISTRATURËS, PËR VITIN AKADEMIK
2020-2021 (i konsoliduar)**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenin 85, pika 1 dhe 262 të ligjit nr.115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, në nenin 29, pika 1 të ligjit nr.96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, në nenin 53, pika 2, 4 dhe 9, në nenin 55 pika 1 si dhe nenin 56 pika 3 të ligjit nr. 98/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, me propozim të Komisionit për Zhvillimin e Karrierës,

VENDOSI:

1. Përcaktimin e numrit të kandidatëve që do të pranohen në programin e formimit fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, për vitin akademik 2020-2021, si më poshtë:
 - a) Numri i kandidatëve për magjistratë, profili gjyqtar, që pas kalimit të testimit profesional, do të pranohen në programin e formimit fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, për vitin akademik 2020-2021, është 40 (dyzet).
 - b) Numri i kandidatëve për këshilltarë dhe ndihmës ligjorë, që pas kalimit të testimit profesional, do të pranohen për të ndjekur për një periudhë prej nëntë muajsh programin e formimit fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, për vitin akademik 2020-2021, është 25 (njëzet e pesë).
 - c) Në rast se, në përfundim të procedurës së aplikimeve për pranimin në formimin fillestar, nuk ka kërkesa që plotësojnë numrin e planifikuar të kandidatëve për këshilltarë dhe ndihmës ligjorë, kuotat e parashikuara në shkronjën “b” do t’i shtohen kandidatëve për magjistratë të profilit gjyqtar.
 - d) ¹Në rast se, në renditjen përfundimtare të testimit profesional ka konkurrentë mbi numrin **75 (shtatëdhjetë e pesë)**, që sipas Rregullores së Brendshme të Shkollës së Magjistraturës kanë arritur pikët e nevojshme për kandidatët për magjistratë, kuotat e planifikuara në pikën 1, shkronja “b” mund t’i shtohen numrit të përgjithshëm të kandidatëve për magjistratë, të profilit gjyqtar. Në çdo rast numri i kandidatëve të shtuar për magjistratë, të cilët kanë aplikuar për profilin gjyqtar, nuk mund të kalojë numrin e planifikuar sipas pikës 1, shkronja “b” të këtij vendimi.

¹ Ndryshuar me vendimin nr. 58 datë 29.01.2020

- e) Në rast se nga konkurrentët nuk arrihen pikët që nevojiten për kandidatët për magjistratë, vendet e mbetura mund t'i shtohen numrit të përgjithshëm të kandidatëve që kanë aplikuar për këshilltarë dhe ndihmës ligjorë, të cilët plotësojnë nivelin minimum të pikëve që parashikohen në Rregulloren e Brendshme të Shkollës së Magjistraturës.
2. Shkolla e Magjistraturës publikon thirrjen për kandidime për formimin fillestar, brenda një jave kalendarike nga data e publikimit të numrit maksimal të kandidatëve për magjistratë, për profilin gjyqtar, sipas pikës 1, shkronja "a" të këtij vendimi, nëpërmjet shpalljes së njoftimit:
 - a) në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Shkollës së Magjistraturës;
 - b) në të paktën një prej gazetave me tirazh më të lartë në vend.
 3. Procesi i regjistrimit për konkurrim të kandidatëve për magjistratë, për profilin gjyqtar, bëhet në Shkollën e Magjistraturës dhe vlerësimi paraprak për plotësimin e kriterëve kryhet sipas rregullave të parashikuara në ligjin "Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".
 4. Shkolla e Magjistraturës njofton kandidatët e interesuar për këshilltarë dhe ndihmës ligjorë për paraqitjen e kërkesave për formim fillestar, nëpërmjet njoftimeve të publikuara:
 - a) pranë gjithë gjykatave;
 - b) në faqet zyrtare të gjykatave, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të Shkollës së Magjistraturës.
 5. Afati për paraqitjen e kërkesave për formim fillestar, nga kandidatët e interesuar për këshilltarë dhe ndihmës ligjorë, është deri më datë 29 shkurt 2020.
 6. Për tu pranuar në provimin e pranimit për formimin fillestar për formimin fillestar për këshilltar dhe ndihmës ligjor, kandidatët duhet të plotësojnë njëkohësisht kriteret e përgjithshme dhe të veçanta si më poshtë :

Kriteret e përgjithshme:

 - a) është shtetas shqiptar;
 - b) ka zotësi të plotë për të vepruar;
 - c) ka përfunduar ciklin e dytë të studimeve universitare për drejtësi, me diplomë "Master i shkencave", ose të barasvlerëshëm me të, sipas përcaktimeve të legjislacionit të arsimit të lartë, referuar nenit 124 të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë";
 - d) ka notë mesatare të përgjithshme mbi 7 (shtatë), si dhe notë mesatare mbi 7 (shtatë) për grupin e lëndëve kryesore, ku përfshihen: E drejta civile dhe e detyrimeve, E drejta penale, (Pjesa e përgjithshme dhe pjesa e posaçme), Procedura civile, Procedura penale, E drejta administrative dhe E drejta kushtetuese. Për të diplomuarit "Juristë", në programe në gjuhë të huaj, parashikohet një koeficient vështirësie i barabartë me 1.2, i cili do të ponderojë mesataren e tyre faktike;
 - e) të mos jetë i dënuar me vendim penal të formës së prerë;
 - f) të mos ketë qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga Sigurimi i Shtetit përpara vitit 1990;
 - g) të mos ketë qenë bashkëpunëtor, informator, ose agjent i shërbimeve sekrete;
 - h) të mos jetë larguar nga detyra për shkaqe disiplinore si dhe të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
 - i) nuk është anëtar i partive politike në kohën e kandidimit.

Kriteret e veçanta për pozicionin Këshilltar Ligjor jo magjistrat:

- a) përvojë profesionale jo më pak se 10 vjet si nëpunës i lartë në sistemin gjyqësor ose të prokurorisë, në administratën publike, profesionet e lira ligjore, mësimdhënie në

- fakultetet e drejtësisë, ose në çdo pozicion tjetër të barasvlershëm me to, në sektorin privat ose organizatat ndërkombëtare;
- b) njohuri në jurisprudencën e gjykatave vendase dhe atyre ndërkombëtare;
 - c) njohuri shumë të mira të paktën të një gjuhe të vendeve të Bashkimit Europian;
 - d) aftësi të shkrimit dhe arsytimit ligjor;
 - e) të jetë autor i artikujve dhe botimeve shkencore në fushën e jurisprudencës.

Kriteret e veçanta për pozicionin Ndhmës Ligjor në gjykatat e apelit:

- a) të kenë përvojë profesionale jo më pak se pesë vjet, duke përfshirë së paku tre vjet përvojë pune profesionale që lidhet me gjykatën.
7. Në dosjen personale për regjistrim, kandidati për këshilltar dhe ndihmës ligjor duhet të paraqesë dokumentet e mëposhtme, ose kopje të tyre të noterizuara:
- a) kërkesën personale, ku të parashtrijë shkaqet e motivimit për të ndjekur programin e formimit fillestar për këshilltarë e ndihmës ligjorë;
 - b) deklaratën ku të garantojë vërtetësinë e dokumentacionit që paraqet;
 - c) diplomat universitare dhe pasuniversitare për studimet që ka ndjekur;
 - ç) jetëshkrimin;
 - d) kartën e identitetit;
 - dh) vetëdeklarimin për gjendjen gjyqësore;
 - e) raportin mjeko-ligjor për aftësimin e tij të përgjithshëm dhe të specializuar në kuadër të kryerjes së detyrës si këshilltar apo ndihmës ligjorë në sistemin e drejtësisë;
 - ë) dëshmi, vërtetime dhe rekomandime nga persona dhe institucione ku kanë punuar pesë vitet e fundit;
 - f) rekomandim nga punëdhënësi i fundit, që vërteton se nuk është larguar nga detyra për shkaqe disiplinore, si dhe nuk ka masë disiplinore në fuqi;
 - g) deklaratë që vërteton se nuk është anëtar i partive politike në kohën e kandidimit;
 - gj) deklaratë që nuk ka qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga Sigurimi i Shtetit përpara vitit 1990; si dhe nuk ka qenë bashkëpunëtor, informator, ose agjent i shërbimeve sekrete.
8. Procesi i regjistrimit për konkurrim i kandidatëve për këshilltar dhe ndihmës ligjorë kryhet në bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës.
9. Kandidatët për këshilltarë dhe ndihmes ligjorë që plotësojnë kriteret, i nënshtrohen konkursit të pranimit, duke paguar tarifën e regjistrimit për pjesëmarrjen në konkurs sipas Rregullores së Brendshme të Shkollës së Magjistraturës.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e botimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR